

VENDIM
Nr. 605, datë 31.8.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS MAKSIMALE, TË KUSHTEVE DHE TË
PROCEDURËS PËR DHËNIEN E NDIHMËS “DE MINIMIS”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton vlerën maksimale, kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës “*de minimis*”.

2. Ky vendim zbatohet për ndihmat e dhëna në të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, me përjashtim të rasteve kur ndihma jepet:

- a) për veprimtaritë e lidhura me eksportin drejt vendeve të tjera;
- b) me kusht përdorimit të produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara.

3. Ky vendim zbatohet për ndihmat “*de minimis*”, që u jepen ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë aktivitet në disa sektorë të ndryshëm, vetëm nëse ndërmarrja ndan, në mënyrë ligjore ose kontabël, aktivitetet ose kostot e aktiviteteve të ndryshme në atë mënyrë që ndihma “*de minimis*” të përdoret vetëm për sektorin dhe aktivitetin, për të cilët është dhënë.

4. Ndihma konsiderohet “e dhënë” në momentin kur ndërmarrja përfituese fiton të drejtën ligjore për të marrë ndihmën, në bazë të një skeme të ndihmës shtetërore apo të një vendimi individual, pavarësisht nga data e pagesës së shumës së ndihmës “*de minimis*”.

5. Në kuptim të këtij vendimi, me “një përfitues të vetëm të ndihmës “*de minimis*”” kuptohet çdo ndërmarrje ose një grup ndërmarrjesh që kanë marrëdhënie me njëra-tjetrën, si më poshtë vijon:

a) Një ndërmarrje ka shumicën e së drejtës së votës si aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, në mënyrë direkte ose indirekte;

b) Një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë shumicën e anëtarëve të bordit, këshillit administrativ, të drejtimit ose të mbikëqyrjes së një ndërmarrjeje tjetër, në mënyrë direkte ose indirekte;

c) Një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë ndikim zotërues mbi një ndërmarrje tjetër në bazë të një kontrate ose të statutit, në mënyrë direkte ose indirekte;

ç) Një ndërmarrje aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër kontrollon shumicën e së drejtës së votës të kësaj të dytës në bazë të një kontrate me aksionarë apo me anëtarë të tjerë, në mënyrë direkte ose indirekte.

II. NDIHMA “DE MINIMIS”

Ndihma “*de minimis*” lejohet nëse përmbushen njëherësh të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Ndihma dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk e kalon vlerën e përgjithshme 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun III, të këtij vendimi.

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun IV, të këtij vendimi.

III. LLOGARITJA E VLERËS TOTALE TË NDIHMËS “DE MINIMIS”

1. Vlera totale e ndihmës shprehet në grant në të holla (*cash*) dhe bazohet në shumën bruto, para zbritjes së taksave ose shpenzimeve të tjera. Në rastet kur ndihma jepet në formë tjetër, vlera e

¹ Ky vendim është përafshuar me rregulloren e Komisionit Evropian nr. 1407/2013, datë 18.12.2013, “Për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën *de minimis*”, numër cellex 32013R1407, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian 2013 L 352, f 1 dhe rregulloren nr. 360/2012 të Komisionit Evropian, “Për zbatimin e nenit 107 dhe 108 TFBE për ndihmën *de minimis*, dhënë ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të interesit të përgjithshëm”, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 2012, L 114, fq 1.

ndihmës është ekuivalenti bruto i ndihmës (EBG).

2. Ndihma që paguhet me këste skontohej në vlerën e saj në momentin e dhënies. Për skontimin përdoret norma e interesit në momentin e dhënies së ndihmës.

3. Në rastin e bashkimit ose blerjes së ndërmarrjeve, ndihma e dhënë para bashkimit ose blerjes duhet të përfshihet në llogaritjen e vlerës totale të çdo ndihme të re “*de minimis*”. Ndihma e ligjshme “*de minimis*”, e dhënë para bashkimit ose blerjes, mbetet e ligjshme.

4. Në rastin e ndarjes së një ndërmarrjeje në dy ose më shumë ndërmarrje të reja, ndihma “*de minimis*”, e dhënë para ndarjes, i bashkëngjitet pjesës së ndërmarrjes që ka përfituar nga ndihma. Kur shpërndarja e ndihmës nuk është e mundur sipas kësaj mënyre, ndihma “*de minimis*” i shpërndahet secilës pjesë, në përpjesëtim me vlerën e kapitalit të çdo ndërmarrjeje të re, siç është i regjistruar në librat kontabël të ndërmarrjes në datën e ndarjes.

5. Ndihma “*de minimis*” mund të mblidhet me ndihmën “*de minimis*” për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, por nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës “*de minimis*” për këto lloj shërbimesh. Çdo mbledhje e ndihmave të tjera “*de minimis*” nuk duhet të kalojë vlerën maksimale të ndihmës “*de minimis*”, të caktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

6. Ndihma “*de minimis*” nuk mund të mblidhet me ndihmë tjetër për të njëjtat kosto ose të njëjtin risk-financim kur mbledhja sjell tejkalimin e intensitetit të ndihmës.

IV. LLOGARITJA E EKVIVALENTIT BRUTO TË GRANTIT (EBG)

1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente.

2. Ndihma në formë borxhi ose kredie është transparente nëse:

a) përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi, sipas legjislacionit në fuqi; dhe

b) kredia nuk kalon shumën prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh për dhjetë vjet dhe shoqërohet me garanci që mbulojnë të paktën 50% të kredisë. Kur kredia është më pak se këto shuma ose kur jepet për një kohë më të shkurtër se pesë apo dhjetë vjet, atëherë ekuivalenti bruto i grantit llogaritet (ulet) proporcionalisht; ose

c) ekuivalenti bruto i grantit është llogaritur mbi bazën e normës së interesit që zbatohet në kohën e dhënies së grantit.

3. Ndihma në formën e kapitalit është transparente nëse shuma totale e kapitalit dhënë një ndërmarrjeje nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës “*de minimis*” (injeksion kapitali).

4. Ndihma e risk-financimit në formën e investimit në kapital ose e ngjashme me kapital aksionar është transparente kur shuma totale dhënë një ndërmarrjeje nuk e kalon vlerën maksimale të ndihmës “*de minimis*”.

5. Ndihma në formën e garancisë është transparente nëse:

a) përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi, sipas legjislacionit në fuqi;

b) garancia nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe kjo kredi nuk kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për dhjetë vjet. Kur kredia është më pak se këto shuma ose kur jepet për një kohë më të shkurtër se pesë apo dhjetë vjet, atëherë ekuivalenti bruto i grantit llogaritet (ulet) proporcionalisht.

V. NDIHMA “DE MINIMIS” PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE

1. Dispozitat e këtij vendimi gjejnë zbatim dhe për ndihmën që u jepet ndërmarrjeve të transportit të mallrave, përveç përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës maksimale të ndihmës, të përcaktuara në këtë kre.

2. Në rastin e ndihmës së dhënë për ndërmarrjet e transportit të mallrave, vlera totale e ndihmës që i jepet një ndërmarrjeje nuk i kalon 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Në rastin kur ndërmarrja e transportit të mallrave ushtron një aktivitet tjetër, të cilit i zbatohet vlera maksimale e ndihmës “*de minimis*” prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh,

kjo ndërmarrje duhet të ndajë, me anë të ndarjes ligjore ose kontabël, aktivitetet ose kostot e aktiviteteve të ndryshme, në mënyrë që aktiviteti i transportit të mallrave të mos përfitojë më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

4. Në rastin e kredive, në kuptimin e pikës 2, të kreut IV, të këtij vendimi, kredia dhënë ndërmarrjes së transportit nuk e kalon shumën prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekësh për dhjetë vjet dhe shoqërohet me garanci që mbulon të paktën 50% të kredisë.

5. Në rastin e garancive, në kuptimin e pikës 5, të kreut IV, të këtij vendimi, garancia e dhënë ndërmarrjes së transportit nuk i kalon 80% të kredisë që garanton dhe kjo kredi nuk kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për pesë vjet ose shumën prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh për dhjetë vjet.

6. Ndërmarrja e transportit të mallrave nuk mund të përdorë ndihmën “*de minimis*” për blerjen e makinave për transport mallrash.

VI. NDIHMA “*DE MINIMIS*” PËR SHËRBIMET ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK

1. Dispozitat e këtij vendimi gjejnë zbatim dhe për ndihmën që u jepet ndërmarrjeve që ofrojnë shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, përveç përcaktimit dhe llogaritjes së vlerës maksimale të ndihmës, të përcaktuara në këtë kre.

2. Në rastin e ndihmës së dhënë për ndërmarrjet, që ofrojnë shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik dhe publik, vlera totale e ndihmës që i jepet përfituesit nuk e kalon vlerën 69 500 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind mijë) lekë për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Në rastin e garancive, në kuptimin e pikës 5, të kreut IV, të vendimit, garancia e dhënë ndërmarrjes nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe pjesa e garantuar e kredisë nuk kalon shumën prej 522 500 000 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.

4. Dhënësit e ndihmës i japin strukturave përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore informacionet e mëposhtme:

- a) Një kopje të mandatit të shërbimit publik;
- b) Vlerën totale të ndihmës;
- c) Shpjegimin e mënyrës së llogaritjes së vlerës totale të ndihmës.

VII. KURSI I KËMBIMIT TË EUROS NË LEKË, NORMA E INTERESIT DHE E SKONTIMIT

1. Për zbatimin e nenit 8, të ligjit dhe të këtij vendimi, vlerat e shumave të mëposhtme caktohen për pesë vjet, si më poshtë vijon:

- a) vlera 50 000 euro në 7 000 000 lekë;
- b) vlera 100 000 euro në 14 000 000 lekë;
- c) vlera 125 000 euro në 18 000 000 lekë;
- ç) vlera 187 000 euro në 25 000 000 lekë;
- d) vlera 250 000 euro në 35 000 000 lekë;
- dh) vlera 375 000 euro në 50 000 000 lekë;
- e) vlera 500 000 euro në 70 000 000 lekë;
- ë) vlera 750 000 euro në 100 000 000 lekë;
- f) vlera 3 750 000 euro në 522 500 000 lekë;
- g) vlera 15 000 000 euro në 2 085 000 000 lekë.

2. Komisioni i Ndihmës Shtetërore me vendim mund të ndryshojë vlerat e mësipërme, në rastin kur rritja ose ulja e kursit të këmbimit të euros në lekë shkakton një ndryshim më të madh se 500 000 lekë të vlerës në lekë, të përcaktuar në pikën 1.

3. Kursi zyrtar i këmbimit të euros në lekë përcaktohet nga Banka e Shqipërisë mbi bazën e udhëzimit të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 66, datë 30.8.2006, “Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë”.

4. Norma e interesit dhe e skontimit përcaktohen me vendim të Komisionit të Ndihmës

Shtetërore për përcaktimin e normave të interesit.

VIII. NJOFTIMI I NDIHMËS “*DE MINIMIS*” DHE KONSTATIMI I LEJUESHMËRISË SË NDIHMËS

1. Ndihamat njoftohen pranë strukturës përgjegjëse për ndihmën shtetërore, e cila kontrollon nëse përmbushen kushtet e para-shikuara në pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi, dhe ia përcjell njoftimin për shqyrtim Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

2. Ndihma njoftohet para dhënies, por njoftimi nuk pezullon pagesën e ndihmës.

3. Komisioni merr një vendim në të cilin konstatohet që ndihma e dhënë përmbush kushtet dhe si rrjedhim lejohet.

4. Nëse Komisioni nuk merr vendim brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, ndihma konsiderohet ndihmë e lejuar.

5. Komisioni merr një vendim për pezullim të ndihmës, nëse konstaton se një ose më shumë kushte të ndihmës “*de minimis*” nuk përmbushen. Ky vendim i njoftohet dhënësit brenda 30 ditësh nga data e marrjes së njoftimit. Komunikimi i këtij vendimi pezullon ndihmën, e cila duhet të shqyrtohet në bazë të kushteve përkatëse të ligjit.

6. Ndihma që nuk përmbush kushtet e mësipërme, që është jashtë fushës së zbatimit të këtij vendimi ose që mbulohet nga përjashtimet e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, njoftohet në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, dhe shqyrtohet në bazë të kushteve përkatëse të përcaktuara në ligjin e sipërpërmendur.

7. Ndihma, që nuk përmban një vlerë maksimale në të holla ose në ekuivalent bruto të grantit, nuk përmbush kushtet e ndihmës “*de minimis*” sipas këtij vendimi. Ndihma njoftohet në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, dhe shqyrtohet në bazë të kushteve e të procedurave përkatëse të përcaktuara në ligjin e sipërpërmendur.

IX. DETYRIMET E DHËNËSIT DHE PËRFITUESIT TË NDIHMËS “*DE MINIMIS*”

1. Dhënësi i ndihmës “*de minimis*” i kërkon ndërmarrjes një deklaratë mbi çdo ndihmë “*de minimis*” të përftuar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim. Ndërmarrja përfituese e ndihmës nënshkruan deklaratën, sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

2. Dhënësi vendos të japë ndihmën “*de minimis*” vetëm nëse shuma e ndihmës së re nuk i kalon vlerat maksimale të caktuara në këtë vendim, duke marrë parasysh shumat e mëparshme të ndihmës “*de minimis*”.

3. Dhënësi informon përfituesin e ndihmës për shumën e grantit në të holla ose për ekuivalentin bruto të grantit dhe të karakterit “*de minimis*”, duke përdorur formularin përkatës, sipas modelit të miratuar me vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

4. Dhënësi dhe përfituesi njoftojnë menjëherë për ndihmën “*de minimis*” pranë strukturës përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë (në vijim struktura).

X. MONITORIMI DHE REGJISTRI I NDIHMAVE “*DE MINIMIS*”

1. Me kërkesë të strukturës, dhënësi dhe përfituesi japin çdo informacion mbi natyrën, qëllimin, shumën dhe llogaritjen e grantit ose ekuivalentit bruto të grantit, mbi çdo ndihmë tjetër të marrë nga ndërmarrja e vetme dhe çdo informacion, të kërkuar nga struktura, në lidhje me ndihmat e marra ose të planifikuara për t'u marrë nga e njëjta ndërmarrje e vetme.

2. Kur struktura vëren se ndihma e dhënë apo e planifikuar ose ndihmat e bashkuara i tejkalojnë vlerat maksimale përkatëse të parashikuara në këtë vendim, ajo hap një procedurë për shqyrtimin e ndihmës ose ndihmave në përputhje me nenin 19 e në vijim të ligjit.

3. Struktura mban një regjister të ndihmave “*de minimis*”, në përputhje me detyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama